



# POLITIKA E QENDRËS KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË (QKSS) PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE DHE TË RINJVE

## 1. QËLLIMI I POLITIKËS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) njeh rëndësinë e mbrojtjes së mirëqenies dhe të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve që mund të jenë ndonjëherë pjesë e projekteve apo aktiviteteve të saj. Kjo politikë është e projektuar për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve brenda kuadrit të aktiviteteve të QKSS. Duke u përputhur me kuadrin ligjor dhe politikën e mbrojtjes së fëmijëve në Republikën e Kosovës, veçanërisht Ligjin Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijëve, QKSS është e përkushtuar për të parandaluar dhunën fizike dhe mendore, abuzimin, shfrytëzimin, neglizhencën dhe çdo formë dëmtimi që rrezikon sigurinë, shëndetin, arsimimin dhe zhvillimin e tyre të përgjithshëm. Kjo politikë përcakton përgjegjësitë dhe udhëzimet për personelin e QKSS që punon me fëmijë, me synimin për të garantuar mbrojtjen dhe mirëqenien e tyre.

## 2. PARIMET DREJTUESE

I gjithë stafi i QKSS-së duhet t'i nënshtrohet kësaj rregulloreje, pa dallim prej pozitës së tyre apo kohëzgjatjes së punësimit. Kjo përfshin stafin me orar të plotë, atyre me orar të pjesshëm apo me orar të përkohshëm. Punonjësit e QKSS-së gjithashtu këshillohen që të angazhohen në praktika të mira mjedisore edhe jashtë ambienteve të zyrës së QKSS-së, duke përfshirë këtu gjatë eventeve si konferencat, trajnimet, seminarët, etj.

**RESPEKTIMI I KUADRIT LIGJOR:** QKSS do të respektojë tashmë kuadrin ligjor dhe institucional për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë.

**PËLQIMI PRINDËROR DHE PRANIA:** Fëmijët dhe të rinjtë mund të marrin pjesë në aktivitetet e QKSS vetëm me pëlqim të informuar nga prindërit ose kujdestarët ligjorë, të cilët duhet të jenë pranë gjatë aktiviteteve. Mirëqenia e fëmijëve është thelbësore.



● **MBROJTJA NGA DËMTIMI:** Fëmijët që marrin pjesë në aktivitetet e QKSS do të mbrohen nga të gjitha format e dëmtimit dhe abuzimit.

● **TË DREJTAT DHE SHPREHJA:** Fëmijët dhe të rinjtë që marrin pjesë në aktivitetet e QKSS do të gëzojnë të drejtat e garantuara nga ligjësia e Kosovës, Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe politikat e Bashkimit Evropian. Kjo përfshin të drejtën për të shprehur veten lirshëm, për të mos marrë pjesë, ose të tërhiqen nga aktivitetet pa shpjegim.

● **SHËNDETI DHE MIREQENIA:** QKSS prioritetizon shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve në të gjitha aktivitetet që i përfshijnë ata.

● **Procedurat e Mbrojtjes:** QKSS zbaton procedura të forta për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi dhe dëmtimi.

● **Edukimi i Personelit:** QKSS vazhdimisht edukon stafin në lidhje me këtë politikë, së bashku me standardet dhe praktikat për mbrojtjen e fëmijëve.

● **Përgjigje e Shpejtë:** QKSS do të trajtojë menjëherë çdo akuza për sjellje të gabuara në përputhje me këtë politikë.

### **3. MASAT PËR TË MBROJTUR FËMIJËT DHE TË RINJTË GJATË AKTIVITETEVE TË QKSS**

● Fëmijët dhe të rinjtë kurrë nuk duhet të lihen pa mbikqyrje gjatë aktiviteteve të QKSS.

● Personeli i QKSS është i ndaluar të qëndrojë vetëm me një fëmijë ose të ri. Gjithmonë, duhet të jenë të pranishëm dy anëtarë të stafit të QKSS kur merren me një fëmijë ose të ri, madje edhe në situata kur nevojitet ndihmë e parë ose ndihmë për shqetësim të përgjithshëm.

● Personeli i QKSS janë në mënyrë rigoroze të ndaluar të takohet me një të ri jashtë ambientit të aktivitetit pa praninë e një personi tjetër.



- Në raste kur fëmijët ose të rinjtë marrin pjesë në ndonjë aktivitet të QKSS, duhet të sigurohen të dhënat e plota prindërore ose të kujdestarëve ligjorë, shoqëruar nga pëlqimi i tyre i informuar dhe prania e vazhdueshme.
- Për projektet e hulumtimit të QKSS që përfshijnë fëmijë ose të rinj, komiteti i etikës së hulumtimit duhet të rishikojë dhe të miratojë masat e veçanta të mbrojtjes për të garantuar mirëqenien e tyre.

## 4. MEKANIZMI RAPORTUES

Çdo individ mund të paraqesë ankesa verbale ose me shkrim lidhur me angazhimin e QKSS me fëmijët ose të rinjtë. Ankesat mund të dërgohen përmes emailit zyrtar të organizatës ([report@qkss.org](mailto:report@qkss.org)) ose numrit të telefonit zyrtar (+383 38 221 420). Udhëheqësja e Operativës në QKSS është përgjegjëse për pranimin dhe shqyrtimin e ankesave, duke ndërmarrë veprime të menjëhershme dhe të nevojshme në konsultim me Drejtorin Ekzekutiv.

Kjo politikë thekson përkushtimin e QKSS për të mbrojtur fëmijët dhe të rinjtë duke njohur të drejtat, sigurinë dhe mirëqenien e tyre si shqetësime kryesore në të gjitha aktivitetet.

Rregullorja hyn në fuqi: 01/08/2023

Mentor Vrajolli,

  
Drejtor Ekzekutiv